

Raport për rezultatet e konsultimeve publike

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar” propozohet në kuadër të nismës së ndërmarrë në Komitetin e Inovacionit, të mbajtur më datë 15.07.2022.

Projektligji është hartuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (DPGJC) dhe Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Brendshme, përgjatë muajit shtator, tetor 2022, duke zhvilluar takimet në Ministrinë e Brendshme.

Projektligji është dërguar për mendim tek ministritë e linjës, në fillim të muajit nëntor 2022.

Konsultimi publik në RENJK për periudhën kohore në respektim të ligjit, nga data 09 nëntor 2022 deri më datë 09 dhjetor 2022. Si përfundim, kohëzgjatja e konsultimit në tërësi ka qenë nga data 15.07.2022 deri më 09.12.2022.

3. Metoda e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Metodat e konsultimit të përdorura për projektligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9270, datë 29.7.2004 “Për sistemin e adresave”, i ndryshuar” ishin dy:

1. Konsultimi elektronik, përmes Regjistrisë Elektronike për Njoftimet dhe Konsultimet, RENJK për periudhë të paktën 20 ditë pune sipas ligjit, duke filluar nga data 09 nëntor 2022 deri më 09 dhjetor 2022.
2. Email.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore Për Çështjet e Brendshme,
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Koordinatori për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJK.

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

<i>Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i>	<i>Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i>	<i>Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i>	<i>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</i>	<i>Justifikimi</i>